



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/106
Datë: 22.01.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet; 103, 104 dhe 105 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/106
Datë: 22.01.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet Plani Zhvillimor Strategjik 2009 - 2013 i Ministrisë së Punëve të Brendshme.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/106
Datë:22.01.2010

Në mbështetje të nenit 92 pika 4, dhe nenit 93 pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2010, mori

V E N D I M

1. Për përmbushjen e kontributit vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal, me seli në Sarajevë, respektivisht në buxhetin e Sekretariatit të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC), ndahen mjete financiare për vitin 2010 në vlerë prej 40.000 (dyzetmijë) euro.
2. Shuma në vlerën e sipërpërmendur formalisht është vendosur në Takimin e Tryezës Rajonale të Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore në Bukuresht, nëntor 2006, në bazë të kontributit të dakorduar vjetor, varësisht prej grupit (Republika e Kosovës bën pjesë në grupin prej 4 % të shumës totale) të vendeve të Evropës Juglindore.
3. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga rezervat e Qeverisë.
4. Obligohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Zyra e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/106
Datë: 22.01.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Avokatin e Popullit.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/106
Datë: 22.01.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L - 28 për Procedurën Administrative.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/106
Datë: 22.01.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të e Terrorizmit.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/106
Datë: 22.01.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2010, mori

V E N D I M

1. Vendbanimi Brod (lagjja Smajlaj) që gjendet në territor të komunës së Shtërpcës, për shkak të rrethqitjes së dheut, shpallet zonë e rrezikuar për banim.
2. Të fillojë zhvendosja e menaxhuar e 6 (gjashtë) familjeve me gjithsej 36 (tridhjetegjashtë) banorë në lagjen Smajlaj.
3. Të bëhet sigurimi i lokacionit (truallit) për vendbanimin e ri rural për banorët e rrezikuar dhe të projektohet ndërtimi i vendbanimit të ri për familjet e rrezikuara.
4. Për realizimin e fazës së parë të këtij projekti për krijimin e vendbanimit të ri ndahen mjetet financiare në vlerë prej 300.000.00 (treqind mijë) euro.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Kuvendi Komunal i Shtërpcës.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/106
Datë: 22.01.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2010, mori

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 20.000 (njëzetmijë) euro ndihmë Ulqinit, pas përmbytjeve nga vërshimet që ndodhën në këtë komunë.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga rezervat e Qeverisë.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/106
Datë: 22.01.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë që t'i lejohet pagesa e paradhënies në shumën prej 635.756,40 euro (gjashtëqindetridhjetë e pesëmijeshatëqindpesëdhjetegjashtë euro e dyzet cent) për blerjen e vaksinave në bazë të Marrëveshjes së nënshkruar në mes UNICEF-it dhe Ministrisë së Shëndetësisë për Programin e Zgjeruar të Imunizimit.
2. Kërkohet nga Kuvendi i Kosovës që të lejojë këtë paradhënie, në mënyrë që t'i mundësohet Ministrisë së Shëndetësisë që nga buxheti i saj të realizojë blerjen e këtyre vaksinave.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë